



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:243871

Datë: 11.06.2024

Numri i dokumentit: 05805211

**PKR.nr.290/21**

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Krime të Rënda, Kryetari i Trupit Gjykses Gëzim Ademi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Albrim Kastrati, në çështjen penale të pandehurës, V. J., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Falsifikimi i rezultateve të votimit nga neni 219 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së (Kodi nr. 04/L-082), të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti për Krime të Rënda, PP.I.nr.494/20 të datës 29.10.2021, konform nenit 287 par 1 të KPPRK-së, me datë 10.06.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**HEDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti për Krime të Rënda, PP.I.nr.494/20 të datës 28.10.2021.

**PUSHOHET** procedura penale kundër të pandehurës:

V. J., nga i ati Xh. dhe nëna Y., e gjinisë B., e lindur më datë ..., në S., me vendbanim në P.Lagjja e S. në rrugën "P.", LL-...,me numër personal ..., ka të kryer fakultetin për punë sociale dhe master psikologji, e pa martuar, e gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptare, Shtetase e Republikës së Kosovës.

Për shkak se prokurori i shtetit është tërhequr nga aktakuza para fillimit të shqyrtimit gjyqësor.

Shpenzimet e procedurës penale mbesin në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzë nën shenjën PP.I.nr.494/20 të datës 28.10.2021, kundër të pandehurve L. K., A. B., F. S., A. M., V. J., F. B., A. A. dhe S. B. për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Falsifikimi i rezultateve të votimit nga neni 219 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së (Kodi nr. 04/L-082).

Në seancën e shqyrtimit fillestar të datës 07.09.2023, Prokurori i Shtetit ka propozuar se me qenë se e pandehura V. J. ka munguar disa herë dhe me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka propozuar që ndaj të pandehurës të veçohet procedura penale, Gjykata me Aktvendimin

PKR.nr.666/2021 të datës 18.09.2023 ka veçuar procedurën penale ndaj të pandehurës duke marr lënda numër të ri PKR.nr.290/21.

Gjykata me datën 10.06.2024 ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën prezent ishte, e pandehura dhe Prokurori i Shteti, Bashkim Zeqaj i cili ka kërkuar fjalën dhe ka deklaruar se, për këta të pandehurit tjerë është marr aktgjykim lirues nga gjykata dhe duke pasur parasysh se për lëndën e natyrës së njëjtë kemi pasur aktgjykime refuzuese dhe lirues, ashtu që në pikëpamje te veprës penale që ngërthejnë dashjen, si element subjektiv të veprës penale, në pajtim me nenin 51 të KPPRK-së tërhiqem nga ndjekja penale ndaj të pandehurës V. J.

Gjykata pas tërheqjes së prokurorit të shtetit nga ndjekja e penale për të pandehurën, analizimit të shkresave të lëndës dhe analizimit të bazës ligjore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, pasi që janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore të parapara me këtë dispozitivë ligjore.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës, u mor në bazë të nenit 453 par.1 të KPRK-së.

Nga sa u tha më larte në bazë të nenit 287 par 1 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv te këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti për Krime të Rënda**  
**PKR.nr.290/21, datë 10.06.2024**

**Bashkëpunëtori profesional**  
Albrim Kastrati

**Kryetari i Trupit Gjykses - Gjyqtari**  
Gëzim Ademi

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesa dhe mund të ushtrohet nga palët e pa kënaqura brenda pesë (5) ditëve, nga dita e pranimit, përmes kësaj gjykate, duke ju drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë.